



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 297/3 Prot.

Tiranë, më 14.07.2022

V E N D I M

Nr.99, datë 14.07.2022

Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, të pretendimeve të nëpunësit *** , për shkelje të dispozitave të legjislacionit të shërbimit civil, të kryera nga Bashkia Vlorë**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësit *****,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është rregjistruar kërkesa me nr.297 prot., datë 21.04.2022, e paraqitur nga nëpunësi ***** , me detyrë “Drejtor në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit”, në Bashkinë Vlorë, përmes së cilës ngrihen pretendime për shkelje të dispozitave të legjislacionit të shërbimit civil, nga ana e institucionit Bashkia Vlorë.

Konkretisht, në përmbajtjen e informacionit të mësipërm parashtrohen pretendimet e tij, për zbatim të gabuar të legjislacionit të shërbimit civil, si më poshtë vijon:

Së pari, me vendimin nr. 147, datë 31.12.2021, “Për dhënie masë disiplinore punonjësve të Bashkisë Vlorë”, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, ndaj nëpunësit ***** , me detyrë “Drejtor në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit”, i është dhënë masa

disiplinore “Vërejtje”, me të cilën nëpunësi është njohur në datë 10.01.2022, nëpërmjet zyrës së protokollit të institucionit.

Sa i takon masës disiplinore të dhënë, nëpunësi ngre pretendimin se, nga ana e eporit direkt nuk janë respektuar kërkesat e parashikuara në kreun X, “Disiplina në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe dispozitat e cituara në kreun II, “Procedura disiplinore”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, të detyrueshme për tu ndjekur nga ana e eporit direkt, në rastin e zbatimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil. Për këtë arsye, nëpunësi ***** me shkresën nr.120 prot., datë 10.01.2022, i është drejtuar njësisë përgjegjëse dhe eporit direkt, përmes së cilës ka kërkuar ti vihet në dispozicion kopje e dokumentacionit të procedurës disiplinore në ngarkim të tij, për të cilën nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Së dyti, nëpunësi pretendon se, në mënyrë të padrejtë në pagën e muajit shkurt 2022, në listprezencën e paraqitur dhe të firmosur nga titullari i institucionit, i janë hequr 5 ditë pune, që korrespondojnë me datat 10 deri në 14 janar 2022, me argumentin për shkak të mungesës në punë në këto data. Sipas sqarimeve dhe dokumentacionit të paraqitur pranë zyrës së burimeve njerëzore, nëpunësi ka provuar se ka qenë prezent në punë në datat 10 dhe 11 janar 2022, ndërsa për datat 12, 13 dhe 14 janar 2022, ka munguar për shkak të karantinimit si rrjedhojë e infektimit të familjarëve të tij (bashkëshortes dhe vajzës) me Covid 19, për efekt prove ka paraqitur raportet mjekësore të lëshuara nga mjeku i familjes. Gjithashtu, ankuesi këtë fakt e ka evidentuar edhe në listprezencën e hartuar prej tij, në cilësinë e nëpunësit zbatues. Për më tepër, prania e nëpunësit në këto data në institucion mund të provohet edhe nga regjistrimi i bërë nga kamerat e sigurisë në institucion. Nëpunësi ***** me shkresën nr. 2903 prot., datë 18.03.2022, drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, për dijeni Kryetarit të Bashkisë Vlorë, ka kërkuar të sqarohet mbi arsyen e heqjes së ditëve të punës në këto data, mbështetur në lisprezencën e firmosur nga titullari i institucionit.

Së treti, me shkresën “Vendim Transferimi”, nr. 17, datë 18.03.2022, (nr. 2936 prot., datë 18.03.2022), të Kryetarit të Bashkisë, nëpunësi ***** është transferuar nga pozicioni “Drejtor në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit”, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit”, Bashkia Vlorë, pozicion i krijuar rishtasi, me Vendimin nr. 9, datë 22.02.2022, “Për disa ndryshime në strukturën organizative të bashkisë Vlorë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2022”, të Kryetarit.

Sipas tij, procedura e transferimit është e paqartë, gjithashtu në Drejtorinë ku është transferuar nuk është hartuar asnjë akt mbi misionin dhe qëllimin e kësaj drejtorie; mungojnë përshkrimet e punës; mungon ambienti dhe mjetet logjistike për kryerjen e

detyrës së ngarkuar; në lidhje me sa më sipër, punonjësi ka vënë në dijeni kryetarin e bashkisë me shkresën nr. 3500 prot., datë 04.04.2022.

Me qëllim hetimin e rastit, me marrjen e këtij informacioni, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, bazuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, kryesisht, ka filluar procesin e verifikimit të ligjshmërisë së këtyre proceseve administrative. Në këtë kuadër, me shkresën nr. 297/1 prot., datë 04.05.2022, me objekt: “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e disa pretendimeve të ngritura nga nëpunësi *****”, në lidhje me zbatimin e drejtë të legjislacionit të shërbimit civil”, si dhe e-mailin e datës 28.04.2022, “Kërkesë për informacion në lidhje me ankesën e nëpunësit *****”, dërguar institucionit Bashkia Vlorë, kërkoi sqarimet për rastin në fjalë si dhe praktikën shkresore të disponuar, duke përfshirë dokumentacionin që materializon veprimet e kryera nga ana e kësaj të fundit.

Në vijim, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Vlorë, përmes e-mailit zyrtar të datës 06.05.2022, me objekt: “Re: Kërkesë për informacion në lidhje me ankesën e nëpunësit *****”, ka paraqitur një pjesë të dokumentacionit të kërkuar për shqyrtimin e rastit.

Për hetimin administrativ të këtij ankimi, po analizojmë dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë institutet e ligjit për nëpunësin civil, të prekura/shkelura në rastin konkret:

Së pari, në kuadër të vlerësimit të ligjshmërisë së procedurës për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, ndaj nëpunësit *****”, me Vendimin nr. 147, datë 31.12.2021, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, konstatojmë se në nenin 57, “Përgjegjësia për masat disiplinore”, përcaktohet se, nëpunësi civil është përgjegjës për shkeljen me faj të detyrimeve sipas ligjit. Gjithashtu në këtë dispozitë bëhet edhe kategorizimi i shkeljeve në:

- a) shkelje shumë të rënda;
- b) shkelje të rënda;
- c) shkelje të lehta.

Më tej, në pikën 2, të këtij neni, parashikohet kategorizimi i shkeljeve shumë të rënda, në pikën 3, në shkelje të rënda dhe në pikën 4, në shkelje të lehta.

Ndërsa, në nenin 58, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, parashikohen “Llojet e masave disiplinore” të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, në një rast kur evidentohen shkelje disiplinore:

“Masat disiplinore që mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil janë:

- a) vërejtje;
- b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj;

c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.

ç) largim nga shërbimi civil”,

dhe në nenin 59, të këtij ligji, përcaktohet kompetenca dhe procedura për dhënien e tyre. Sipas pikës 2, të kësaj dispozite, masa e parashikuar në germën a) të nenit 58, jepet nga eprori direkt i nëpunësit, ndërsa masat e parashikuara në germat b), c) dhe ç) jepen nga Komisioni Disiplinor, për çdo nëpunës civil në institucion.

Në referim të pikës 10, të nenit 59, të ligjit në fjalë, është parashikuar se, Këshilli i Ministrave miraton me vendim rregullat e hollësishme të procedurës disiplinore, si dhe rregullat për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor. Ky detyrim ka gjetur zbatim me miratimin e Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*, i ndryshuar.

Konkretisht, në aktin nënligjor që rregullon disiplinën në shërbimin civil, (VKM nr.115/2014), në kreun I *“Organet Disiplinore”*, pika 1, përcaktohet se:

“Organet disiplinore, sipas ligjit, janë: Komiteti Kombëtar i Përzgjedhjes, për anëtarët e TND-së (KKP); komisioni disiplinor (KD), për nëpunësit e tjerë, dhe eprori direkt”.

Sa i takon procedurës që duhet të ndiqet nga ana e organeve disiplinore, në rastin konkret, nga ana e eprorit direkt, pikat 13 deri 20, të VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014, i ndryshuar, parashikojnë të gjitha hapat e kërkuar për nisjen e ecurisë disiplinore nga eprori direkt, kur shkelja disiplinore konsiderohet e lehtë; njoftimin me shkrim të nëpunësit, duke e njohur me faktin e pretenduar si shkelje disiplinore; faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedimit disiplinor në ngarkim të tij; si dhe duke i dhënë mundësi nëpunësit të mbrohet, të paraqesë prapësimet dhe prova për të provuar se nuk ka kryer ndonjë shkelje disiplinore me faj.

Vetëm në përfundim të këtij procesi kompleks, eprori direkt në mbështetje të të gjithë akteve të administruara gjatë procedurës së hetimit disiplinor, duhet të marrë një vendim të argumentuar, të mbështetur në prova, nëse nëpunësi e ka kryer ose jo shkeljen dhe në rastet kur ekziston elementi i fajësisë për shkeljen e kryer, jepet masa disiplinore.

Kjo procedurë që duhet të ndiqet gjatë ecurisë disiplinore, e cituar në VKM nr.115, datë 05.03.2014, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*, i ndryshuar, në mënyrë edhe me të detajuar për secilën fazë të saj parashikohet në Udhëzimin nr. 01, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, *“Elementet kryesorë proceduralë dhe materiale të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”*, të cilit organi i disiplinës duhet ti referohet për analogji.

Sa i takon verifikimit të procedurës së ndjekur gjatë procesit të ecurisë disiplinore, nga ana e eprorit direkt të nëpunësit *****, me e-mailin zyrtar të datës 11.05.2022, dërguar Bashkisë Vlorë, është rikërkuar dokumentacioni i administruar gjatë kësaj procedure, kërkesë kjo që është përsëritur me e-mailin e datës 19.05.2022, duke risjellë në vëmendje detyrimin e institucionit dhe njësisë përgjegjëse për tu përgjigjur në kohë kërkesës së Komisionerit.

Me e-mailin e datës 19.05.2022 nga institucioni Bashkia Vlorë, Komisioneri ka marrë dijeni se ndaj nëpunësit *****, është marrë masa disiplinore “Vërejtje”, pasi ky punonjës nuk është paraqitur në mbledhjen e njoftuar me Kryetarin e Bashkisë, në cilësinë e “Drejtorit të Drejtorisë së Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit”, pa e shoqëruar sqarimin përkatës me dokumentacion provues të faktit.

Në mbështetje të dokumentacionit dhe sqarimeve të dhëna nga institucioni Bashkia Vlorë, rezulton se, eprori direkt i nëpunësit *****, nuk ka ndjekur hapat ligjorë të kërkuar gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore në ngarkim të këtij nëpunësi, përse kohë që nuk provohet me dokumentacionin përkatës.

Në këto kushte, Vendimi nr. 147, datë 31.12.2021, (nr. 17049 prot., datë 31.12.2021), “Për dhënie masë disiplinore punonjësve të Bashkisë Vlorë”, të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, dhënë nëpunësit *****, me detyrë “Drejtor në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit”, mbështetur në germën b), të nenit 109, “Paligjshmëria e aktit administrativ”, të Kodit të Procedurave Administrative, i cili parashikon se: “Një akt administrativ është i paligjshëm nëse, është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;...”, duhet të konstatohet si një akt i paligjshëm, nga vetë organi publik i cili e ka nxjerrë aktin, dhe ta anullojë atë.

Së dyti, në lidhje me pretendimin e nëpunësit, se në mënyrë të padrejtë në pagën e muajit shkurt 2022, në listëprezencën e paraqitur dhe të firmosur nga titullari i institucionit, i janë hequr 5 ditë pune, që korrespondojnë me datat 10 deri në 14 janar 2022, me argumentin për shkak të mungesës në punë në këto data, rezulton se, ky pretendim qëndron.

Nga dokumentacioni i dërguar nëpërmjet e-mailit zyrtar të datës 06.05.2022 dhe të datës 06.06.2022, nga institucioni Bashkia Vlorë, është dërguar listëprezencën e muajit janar 2022, ndërsa me e-mailin e datës 19.05.2022, nga institucioni është sqaruar se, nëpunësi ***** prej datës 10.01.2022- 14.01.2022, nuk është paraqitur në detyrë dhe nuk ka njoftuar për fillimin e raportit mjekësor eprorin direkt dhe/ose Drejtorinë e Burimeve Njerëzore. Ky raport është paraqitur nga punonjësi në fund të muajit janar së bashku me listëprezencën e drejtorisë, me pretendimin se në datat 10 dhe 11 janar 2022, ka qenë prezent në punë.

Nga dokumentacioni i paraqitur nga nëpunësi *****, provohet se, mungesat në datat 12-14 janar 2022 në punë, kanë qenë të justifikuara për shkak të karantinimit, si rrjedhojë e infektimit të familjarëve të tij (bashkëshortes dhe vajzës) me Covid 19. Për vërtetim të këtij

fakti, nëpunësi ka paraqitur Vërtetim nr. 123 regjistër, datë 15.01.2022, lëshuar nga Qendra Shëndetësore nr. 4, Vlorë, me anë të së cilit provohet vetëizolimi për periudhën 10.01.2022 deri më 15.01.2022. Gjithashtu, ankuesi ka paraqitur edhe raportet mjekësore të lëshuara nga mjeku i familjes “Raport për paaftësi të përkohshme në punë nr. 123 regjistër, datë 07.01.2022”, me diagnozë Covid 19, për periudhën 07.01.2022-17.01.2022, për bashkëshorten dhe “Testin COVID 19” datë 06.01.2022, lëshuar nga laboratori “Planta Laboratory”, për vajzën.

Në mbështetje të dokumentacionit provues, të lëshuar nga institucionet mjekësore, të dorëzuara pranë institucionit punëdhënës nga ankuesi, sikurse pranohet edhe nga vetë ky i fundit, vërtetohet se mungesat në punë të nëpunësit ***** në datat 10 deri në 14 janar 2022, kanë qenë plotësisht të justifikuar. Në këto rrethana, mbështetur në dispozitat e përcaktuara në Vendimin nr. 568, datë 06.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe tëpushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet epavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”, ndalimi i pagës për këto ditë pune, për nëpunësin ***** ka qenë i pajustificuar, si rrjedhim Drejtoria e Financës në bashkëpunimin me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, duhet të verifikojnë edhe një herë prezencën në punë në këto data të ankuesit ***** dhe në vijim të marrin masa konkrete, për të kompensuar financiarisht ditët e punës të papaguara padrejtësisht nëpunësit.

Së treti, sa i përket aktit “Vendim Transferimi”, nr. 17, datë 18.03.2022, (nr. 2936 prot., datë 18.03.2022), të Kryetarit të Bashkisë, me anë të së cilit, nëpunësi ***** është transferuar nga pozicioni “Drejtor në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit”, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit”, në Bashkinë Vlorë, pozicion i krijuar rishtasi, me Vendimin nr. 9, datë 22.02.2022, “Për disa ndryshime në strukturën organizative të bashkisë Vlorë dhe institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2022”, të Kryetarit, konstatohet se:

Me vendimin nr. 78, datë 02.12.2021, (nr. 15839/1 prot., datë 06.12.2021, “Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara 2022”, të Këshillit të Bashkisë Vlorë, është miratuar numri i punonjësve të Bashkisë Vlorë dhe institucioneve të varësisë së saj, për vitin 2022, verifikimi i ligjshmërisë së këtij akti është përcjellë me shkresën nr. 944/2 prot., datë 15.12.2021, të institucionit të Prefektit të Qarkut Vlorë. Më tej, me Vendimin nr. 1, datë 10.01.2022, “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Vlorë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara 2022”, të Kryetarit të bashkisë Vlorë, është miratuar struktura organizative e kësaj bashkie.

Një muaj më pas, me Vendimin nr. 9, datë 22.02.2022, (nr. 1852 prot., datë 22.02.2022), të Kryetarit, “Për disa ndryshime në strukturën organizative të bashkisë Vlorë dhe institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara për vitin 2022”, është miratuar ndryshimi i strukturës së Bashkisë Vlorë, ku në përbërje të saj është shtuar një njësi

organizative “Drejtoria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit”, me përbërje 1 Drejtor + 4 Specialistë.

Me shtimin e njësisë organizative “Drejtoria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit”, në strukturën e bashkisë, titullari i institucionit me aktin nr. 2935 prot., datë 18.03.2022, “Kërkesë për transferim”, drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, për nevoja të institucionit ka kërkuar transferimin e punonjësve:

***** nga pozicioni “Drejtor i Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit”, pozicion në të cilin i është deklaruar statusi si nëpunës civil me aktin 2010 prot., datë 23.05.2014, të njësisë përgjegjëse, në pozicionin “Drejtoria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit”.

***** nga pozicioni “Drejtor Juridik”, në pozicionin “Drejtor i Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit”.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, me aktin “Vendim Transferimi”, nr. 17, datë 18.03.2022, (nr.2936 prot., datë 18.03.2022), titullari i institucionit ka vendosur transferimin e ***** në pozicionin “Drejtori i Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit”, në Bashkinë Vlorë.

Pas miratimit të aktit të transferimit, me Vendimin nr. 30, datë 13.04.2022, (nr.3936 prot., datë 13.04.2022), të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, është miratuar shtesa në “Rregulloren e brendshme të institucionit”, në të cilën është përfshirë edhe misioni; detyrat e Drejtorit dhe të Specialistëve të “Drejtorisë së Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit”, ç’ka provon se në momentin e transferimit të punonjësit ***** si Drejtor në këtë drejtori, ndryshimi i rregullores nuk është kryer si dhe nuk janë hartuar përshkrimet për pozicionet e reja të punës të krijuara, duke shkelur dispozitat e përcaktuara pika 14, e kreut IV, të Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Ndër të tjera, rregullat e këtij akti nënligjor parashikojnë se përshkrimet e punës për çdo pozicion pune të strukturës së re, i bashkëlidhen propozimit për ndryshimin e strukturës, veprim i cili nuk është ndërmarrë me krijimin e njësisë së re organizative, pasi nuk u paraqit asnjë provë që të vërtetojë të kundërtën.

Sa i takon, aktit të transferimit të punonjësit ***** baze ligjore mbi të cilat duhet të bëhet vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të transferimit të përkohshëm, është e parashikuar në përcaktimet e nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në Vendimin nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, si dhe të Udhëzimit nr. 1, datë 01.03.2016, të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe

kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit”.

Konkretisht, në pikën 1, të nenit 48, të ligjit 152/2013, i ndryshuar, parashikohet se:

“Nëpunësi civil mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori, për këto arsye dhe kohëzgjatje:

- a) në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 viteve;
- b) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj gjatë 2 viteve;
- c) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzënisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për aq sa është e nevojshme sipas vendimit të komisionit përkatës. ...”

Ndërsa në pikën 7, të ligjit përcaktohet se, Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishëm për procedurën e transferimit e për këtë qëllim ka dalë Vendimi nr. 125, datë 17.02.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, i cili në kreun I, parashikon se:

“ ...

Pika 10. Njësia përgjegjëse merr vendim brenda 10 (dhjetë) ditëve pas afatit të përcaktuar në pikën 9, të këtij vendimi. Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës dhe përveç rasteve të parashikuara në pikën 9, të këtij vendimi, është i detyrueshëm.

Pika 11. Institucionet ku bëhet transferimi, mënyra e pagesës dhe rikthimi në vendin e punës bëhen sipas përcaktimeve të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Pika 12. Kthimi në vendin e punës bëhet nga njësia përgjegjëse pas mbarimit të afateve të parashikuara në vendimin e njësies përgjegjëse dhe jo më vonë se afatet e parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi. dhe në këtë vendim. ...”.

Sipas parashikimeve të cituara sa më lart, rezulton e qartë se transferimi i përkohshëm i nëpunësve civilë bëhet me vendim të njësies përgjegjëse, duke përcaktuar afatin e transferimit, si dhe rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës pas mbarimit të afateve të parashikuara në vendimin e njësies përgjegjëse.

Në rastin konkret, Vendimi nr. 17, datë 18.03.2022, (nr. 2936 prot., datë 18.03.2022), i nxjerrë nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, nuk përmban elementët e kërkuar të aktit të transferimit të përkohshëm. Në të njëjtën kohë, akti nuk përmban as elementët e nevojshëm të një transferimi të përhershëm, i cili parashikohet në nenin 50, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe në Kreun II, III dhe IV, të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, pasi nga institucioni nuk është paraqitur asnjë provë e një procedure rstrukturimi. Në këto kushte, në zbatim të nenit 109, “Paligjshmëria e aktit administrativ”,

të Kodit të Procedurave Administrative, ky akt transferimi duhet të vlerësohet si akt i paligjshëm dhe në bazë të nenit 113, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, me një akt të ri me shkrim, vetë organi publik që e ka nxjerrë, duhet të vendosë anulimin e tij, duke urdhëruar kthimin e nëpunësit ***** në pozicionin e mëparshëm të punës.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkojë nga organi publik, Bashkia Vlorë, me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë, të vepohet si më poshtë:

Kryetari i Bashkisë Vlorë, të anulojë Vendimin nr. 147, datë 31.12.2021, (nr. 17049 prot., datë 31.12.2021), “Për dhënie masë disiplinore punonjësve të Bashkisë Vlorë”, me të cilin i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” nëpunësit ***** me detyrë “Drejtore në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit”.
2. Të kërkojë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Bashkisë Vlorë, të verifikojë edhe një herë prezencën në punë në datat 10 deri 14 janar 2022, për punonjësin ***** dhe pasi të rivlerësojë dokumentacionin justifikues të paraqitur, të marrë masa konkrete, për të kompensuar financiarisht ditët e punës të papaguara padrejtësisht nëpunësit.
3. Të kërkojë nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, të anulojë Vendimin nr. 17, datë 18.03.2022, (nr. 2936 prot., datë 18.03.2022), “Vendim Transferimi”, për transferimin e nëpunësit ***** në pozicionin “Drejtore në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit”, në Bashkinë Vlorë, duke urdhëruar kthimin e tij në pozicionin e punës “Drejtore në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit”, ku ai ka emërimin e rregullt.
4. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat 10 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.

5. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Vlorë si dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha